



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2021:115836

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05621263

**E.nr.03/06**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**–Dega në Shtërpcë, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen përmbartimore të kreditorit Nj.Zh.A. (ABU), me seli në Prishtinë, rr “...”, nr...., kundër debitorit P.P.T.U “S.” D.O.O, me seli në ..., Komuna e Shtërpcës, me pronar R.M., të cilin me autorizim e përfaqëson av Hekuran Haxhimusa nga Prishtina, për pagesën e borxhit, më datë 25.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Propozimi i kreditorit Nj.Zh.A. (ABU), i datës 15.11.2006, i ushtruar kundër debitorit P.P.T.U “S.” D.O.O, për pagesën e borxhit, **KONSIDEROHET I TËRHEQUR.**

**A r s y e t i m i**

Kreditori Nj.Zh.A. (ABU), më datën 15.11.2006, ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit P.P.T.U “S.” D.O.O, për pagesën e borxhit në shumë prej 33,250.87 euro, në bazë të kontratës së pengut të datës 15.09.2004.

Gjykata pas lejitimit të përmbartimit, e ka caktuar seancën dëgjimore publike me qëllim që nga palët të merr informacion më të hollësishëm rreth pagesës së detyrimit nga debitori, mirëpo nga fletkthesa e kthyer është konstatuar se adresa e kreditorit është e panjohur edhe pse i njëjti me rastin e ndërrimit të adresës ka pas për detyrë që gjykatën ta njoftoj për ndërrimin e adresës dhe këtë nuk e ka bërë. Gjykata, duke vepruar sipas nenit 116.5, të LPK-së, lidhur me nenin 17, të LPP-së, me aktvendimin e datës 03.04.2024, e ka caktuar seancën dëgjimore publike për datën

25.04.2024, dhe kreditorin e ka ftuar përmes tabelës së shpalljeve të gjykatës. Gjykata me datën 25.04.2024, e ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ftesën për kreditorin përmes tabelës së shpalljeve e konsideroj të rregullt ndërsa kreditori nuk ka ardhur në seancën dëgjimore.

Me dispozitën e nenit 423, par 3, të LPK-së, është paraparë shprehimisht me ligj: *“Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”*. Andaj, meqenëse ftesa për pjesëmarrje në seancën dëgjimore publike kreditorit i është dërguar në mënyrë të rregullt dhe i njëjti nuk ka ardhur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, Gjykata konstatoj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 423, par 3, të LPK-së, lidhur me nenin 17, të LPP-së, që propozimi për përmbarim i kreditorit i ushtruar kundër debitorit të konsiderohet i tërhequr.

Andaj, Gjykata duke u bazuar në nenin 423, par 3, të LPK-së, lidhur me nenin 17, të LPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e konsideruar si të tërhequr propozimin për përmbarim të kreditorit.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega në Shtërpc**

E.nr.03/06, më datë 25.04.2024

**Gjyqtari**  
**Faton Ajvazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,  
Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditësh,  
nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.